



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MALLAKASTËR**  
Njësia e Prokurimit

**Ballsh, më 30.01.2019**

**SHTOJCË**

**në Dokumentat Standarte të Tenderit me objekt:  
“Karburant (Diezel)”, me referencë në SPE: REF-03835-01-15-2019**

Bazuar në nenin 42 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 62 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në Manualin e APP-së nr.02, datë 06.02.2018 “Për rolin e administratorit të sistemit të autoritetit kontraktor, për rolin e nëpunësit të autorizuar të njësisë së prokurimit dhe për rolin e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, në sistemin e prokurimit elektronik”, duke marrë shkas nga rekomandimet e ardhura nga Agjencia e Prokurimit Publik, reflektuar në procesverbalin e datës 29.01.2019 “Mbi rishikimin e kërkesave të veçanta për kualifikim...”, Njësia e Prokurimit, vendosi të hartojë këtë shtojcë duke bërë riformulimin e dy kërkesave për kualifikim si vijon:

**1. Shkronja “b” në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik”, në shtojcën 9 të DST, riformulohet si më poshtë:**

- b. Stacioni i propozuar për shitjen e karburantit duhet të jetë në pronësi ose me kontratë qiraje noteriale të vlefshme dhe e shënuar si adresë në QKB-në e Operatorit Ekonomik.  
Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:
- Në rastin kur stacioni i karburantit është në pronësi, duhet të paraqitet çertifikata për vërtetimin e pronësisë lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
  - Ndërsa në rastin kur stacioni i karburantit është me qira, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qirasë (e vlefshme), shoqëruar me çertifikatën përkatëse për vërtetimin e pronësisë lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

**2. Shkronja “e” në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik”, në shtojcën 9 të DST, riformulohet si më poshtë:**

- e. Për stacionin e propozuar për shitjen e karburantit, Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi të tipit C, kodi III.1.A, të lëshuar nga QKB.

**3. Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave, ndryshohet dhe bëhet:**

Data: **13.02.2019, Ora: 11:00**

Adresa: Prokurim elektronik në adresën zyrtare të internetit të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Kjo shtojcë hartohet në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, i bashkëngjitet dokumentave standarte të tenderit të kësaj procedure duke u bërë pjesë integrale e tyre, si dhe ngarkohet në sistemin e prokurimit elektronik për operatorët ekonomikë të interesuar.

**NJËSIA E PROKURIMIT**